

VENDIM
Nr. 213, datë 28.7.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË “HIDROINVEST 1” SHPK PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES ME SHOQËRINË OSSH SHA, LIDHUR ME KONFIGURIMIN
TEKNIK TË LIDHJEVE 35 kV NË TRANSFORMATORIN TR-1 TË NËNSTACIONIT
PËRRENJAS**

Në mbështetje të neneve 16, 20, geramat “a” dhe “ë”, 26, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 15 dhe 23, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016; të nenit 11, të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.7.2026, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve me nr. 471/5 prot., datë 27.7.2026, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hidroinvest 1’ sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë ‘OSSH’ sh.a., lidhur me konfigurimin teknik të lidhjeve 35 kV në transformatorin TR-1 të nënstacionit Përrenjas”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k., me shkresën nr. 7 prot., datë 30.1.2026, të protokolluar pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me nr. 471 prot., datë 3.2.2026, i është drejtuar ERE-s me kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshjeje të lindur me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., lidhur me konfigurimin teknik të lidhjes në tensionin 35 kV në nënstacionin Përrenjas, ku janë lidhur centralet e shoqërisë “Hidroinvest 1” sh.p.k. (HEC Stranik dhe HEC Zall Tore) në transformatorin TR-1 (110/35/6 kV, 20 mVa), si dhe mosfunksionimin e mbrojtjes diferenciale të këtij transformatori.

- Sipas shoqërisë “Hidroinvest 1” sh.p.k., problematika buron nga lidhja, në të njëjtin terminal 35 kV të transformatorit TR-1, e një hidrocentrale tjetër (HEC Lingjaca), në pronësi të shoqërisë “Rei-Energji” sh.p.k., e realizuar në mënyrë “kokë-më-kokë”, jashtë standardeve teknike të pranueshme për mbrojtjen diferenciale të transformatorit. Kjo ka shkaktuar një incident në prill të vitit 2024 dhe paraqet rrezik të vazhdueshëm për jetën dhe shëndetin e personelit operativ, si dhe për vazhdimësinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria, me shkresën nr. 12, datë 5.6.2024, i është drejtuar Drejtorisë së Tensionit të Lartë, si dhe i është drejtuar në mënyrë të përsëritur OSHEE sh.a. nëpërmjet shkresave nr. 12/1, datë 30.1.2025 dhe nr. 12/2 prot., datë 14.5.2025. Me shkresën nr. 6501/4 prot., datë 1.7.2025, OSSH sh.a. i është përgjigjur Drejtorisë së Tensionit të Lartë, duke sqaruar se, në skemën aktuale, është e pamundur zbatimi i mbrojtjes diferenciale të transformatorit TR-1, për shkak të lidhjes “kokë-më-kokë” të dy hidrocentraleve (Hidroinvest 1 dhe Rei-Energji/HEC Lingjaca) në krahun 35 kV të transformatorit.

- Shoqëria i është drejtuar përsëri OSHEE sh.a. me shkresën nr. 12/3 prot., datë 20.11.2025, por pa marrë një zgjidhje konkrete.

- ERE, me anë të shkresës nr. 471/1 prot., datë 18.2.2026, ka kërkuar nga OSSH sh.a. informacione dhe shpjegime, lidhur me sa pretenduar nga shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k., duke i lënë një afat prej 10 ditësh për shpjegime/informacione, për të cilën nuk mori përgjigje.

- Në seancën dëgjimore të datës 24.3.2026, përfaqësuesit e OSSH sh.a. deklaruan se mbrojtja diferenciale e transformatorit TR-1 aktualisht nuk funksionon dhe se lidhja e kryer nga HEC “Lingjaca” në krahun 35 kV është jashtë kushteve teknike. OSSH sh.a. ka shprehur gatishmëri për bashkëpunim teknik dhe mbështetje me burime njerëzore për gjetjen e një zgjidhjeje.

- Shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k. është licencuar për prodhimin e energjisë elektrike me vendimin e ERE-s nr. 113, datë 24.9.2008, ndryshuar me vendimin nr. 6, datë 20.1.2010, ndërsa OSSH sh.a. është operator i licencuar i sistemit të shpërndarjes me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, i ndryshuar me vendimet nr. 216, datë 11.10.2018 dhe nr. 224, datë 9.11.2021.

- Objekti i mosmarrëveshjes së ngritur nga shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k., lidhur me konfigurimin teknik të lidhjeve në tensionin 35 kV në nënstacionin Përrenjas dhe mosfunksionimi i mbrojtjes diferenciale të transformatorit TR-1, përbën një mosmarrëveshje teknike dhe rregullatore, e cila hyn në fushën e zbatimit të nenit 20, germa “ë”, dhe nenit 26, të ligjit nr. 59/2026, si dhe të rregullores së miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

- Në këto rrethana, vlerësohet se çështja e paraqitur përbën një mosmarrëveshje ndërmjet dy subjekteve të licencuara dhe se palët legjitimohen për t’iu drejtuar ERE-s për zgjidhjen e saj, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me konfigurimin teknik të lidhjes 35 kV në nënstacionin Përrenjas dhe mbrojtjen diferenciale të transformatorit TR-1, dhe fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje, në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petra Lika